



01Nr.1305-75/2025-Gj

Inspektoret e Punës në MFPT-IQP, [REDACTED] e autorizuar sipas dispozitës së nenit 82 dhe 94 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitës së nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9, dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.08/L-067 për Inspektimet, në shqyrtim të ankesës me nr. 1162/25, të datës 24.11.2025, të parashtruar nga ankuesja znj. [REDACTED] kundër punëdhënësit Q.D.P "Fizident" sh.p.k , adresa: "Hamëz Jashari", nr.28, lidhur me marrëdhënien e punës , me datë 09.01.2026, merr këtë:

V E N D I M
(për shqiptimin e masës ndëshkimore)

REPUBLIC OF KOSOVO
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Inspektorati Qendror i Punës
Central Labour Inspectorate

№ i/le/2025 01
09.01.2026
PRISHTINE / PRISHTINA / PRISTINA

Me rastin e inspektimit të kryer sipas ankesës së palës ankuese Znj. [REDACTED] ndaj subjektit Q.D.P "Fizident" sh.p.k , adresa: "Hamëz Jashari", nr.28, me numër unik identifikues 811882762, u konstatua së është përgjegjës për:

- Për cënimin e dispozitës së nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, e sanksionuar me dispozitën e nenit 92 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, lidhur me dispozitën e nenit 7 paragrafi 2 pika 2.2 i UA 07/2012, për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete, për Shkeljen e Dispozitave të Ligjit të Punës, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 100.00€ (njëqindë euro).
- Për cënimin e dispozitës së nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës , e sanksionuar me dispozitën e nenit 92 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, lidhur me dispozitën e nenit 7 paragrafi 2 pika 2.1 i UA 07/2012, për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete, për Shkeljen e Dispozitave të Ligjit të Punës, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 100.00€ (njëqindë euro).

Andaj shqiptohet: masa ndëshkimore në vlerë prej 200.00€ (dyqindë euro).

Obligohet personi juridik që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i këtij Vendimi, për gjobën e shqiptuar ta merr UNIREF-in në zyrat e Inspektoratit të Punës dhe të paguaj në llogarinë bankare [REDACTED] duke u thirrur në numrin e këtij Vendimi. Dëftesa për kryerjen e pagesës merret në zyre të Inspektoratit të Punës objekti "Qendra Transite Postare", kati 1, Zona Industriale Prishtinë.

Kopja e pagesës, në momentin e kryerjes së obligimit, duhet t'i prezantohet Inspektorëve të Punës, ose të dërgohet në adresë objekti "Qendra Transite Postare", kati 1, Zona Industriale Prishtinë, në të kundërtën do të iniciohet procedurë përmbarimore.

Arsyetim

Më datë 29.12.2025, është kryer inspektimi , sipas parashtrës së ankueses [REDACTED] e cila ka pretenduar se punëdhënësi nuk i ka ofruar kontratë të punës dhe nuk e ka lajmëruar në ATK, si dhe nuk i'a ka paguar kontributet pensionale.

Inspektorët e punës me datë 29.12.2025 kanë kryer inspektim në subjektin si në preambulë të raportit, me çrast punëdhënësi nuk prezantoi kontratën e punës si dhe dëshmi se ankuesja është lajmëruar në Administratën Tatimore të Kosovës.

Punëdhënësit i është dhënë afatë që deri më datë 05.01.2026, të prezantoj kontratën e punës si dhe dëshmi se ankuesja është lajmëruar në ATK. Punëdhënësi edhe pas këtij afati nuk ka arritur të prezantoj dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët e punës. Andaj bazuar në atë që u tha më lartë punëdhënësi ka bërë shkelje të nenin 7.4 dhe 10 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212.

Duhet theksuar se ankuesja në ankesë ka pretenduar që nuk ju kanë paguar kontributet pensionale. Ankueses i sqarohet se sa i përket kontributeve pensionale ti drejtohet organeve tjera kompetente, sepse IQP-ja , ka kompetenc të evidentoj si shkelje vetëm nëse punëdhënësi nuk e ka lajmëruar në ATK.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë, punëdhënësi ka bërë shkelje të nenit 7.4 dhe 10 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Inspektore e Punës

[REDACTED]
[REDACTED]

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi lejohet ankesë në afat prej 30 ditësh, në Komisionin e Ankesave të Inspektoratit Qendror të Punës, nëpërmes Inspektoratit të Punës në Prishtinë, Rr. "Azizë Abrashi", p.n, "Objekti Qendra Tranzite Postare, Zona Industriale Prishtinë - Fushë Kosovë".